



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 18.01.2019)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:54 dhe mbaroi në orën 13:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Medi Bici | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
2. *Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
4. *Luljeta Laze, Drejtoreshë e ZABGJ-së.*
5. *Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
6. *Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
7. *Përfaqësues të EURALIUS-it.*
8. *Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

1. Mbi miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Të fillojmë?

Faleminderit! Faleminderit, që jeni në këtë mbledhje!

Sipas rendit të ditës, sot kemi dy çështje për të diskutuar. Së pari, miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe, së dyti, miratimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Jeni dakord me rendin e ditës?

(Anëtarët janë dakord.)

Dakord!

Atëherë, siç jeni në dijëni, lidhur me strukturën, unë këtë strukturë jua kam shpërndarë para disa ditëve. Unë jam munduar që në këtë strukturë të reflektoj çfarë ligji parashikon si struktura detyruese dhe gjithashtu kam reflektuar të gjithë sugjerimet që ju më keni dhënë.

Doja t'ju informoja që struktura, pasi miratohet nga ne këtu në këtë mbledhje, do i përcillet Kuvendit të Shqipërisë, i cili për shkak të ligjit të menaxhimit të buxhetit, për institucione që krijohen për herë të parë, miraton strukturat për herë të parë të këtyre institucioneve.

Kështu që, për të kaluar në votimin, në diskutimin e strukturës, kemi ndonjë diskutim lidhur me përmbajtjen e strukturës?

Medi Bici: Ta marr unë fjalën?

Naureda Llagami: Po!

Medi Bici: Zonja Kryetare, ne jemi marrë këto ditë me studimin e organigramës që na keni sjellë, kemi bërë vërejtjet tona në disa pika. Atë çfarë shikoj unë në këtë strukturë që na paraqitni, janë pasqyruar ato që ne kishim merak dhe mendonim që do t'i shërbenin më mirë punës dhe pikërisht ish-in Njësia mbështetëse e Komisioneve të Përhershme dhe Njësia e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve, që në këtë strukturë shikoj që janë pasqyruar. Kështu që nuk kisha asnjë vërejtje për këtë dhe mendoj që duhet kaluar në votim.

Naureda Llagami: Zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, edhe unë si gjyqtar Mediu, mendoj që struktura ka reflektuar të gjitha shqetësimet tona. Paraprakisht ne na është bërë e ditur struktura më herët. Kemi diskutuar qoftë individualisht, po ashtu edhe bashkërisht të gjithë. Kemi dëgjuar edhe nëpunësit e administratës që na kanë sqaruar për të gjithë skemën e strukturës së Këshillit të Lartë Gjyqësor. Shqetësimet që unë kam pasur më rezultojnë që janë reflektuar në këtë strukturë. Uroj që kjo strukturë të kalojë edhe pranë Kuvendit të Shqipërisë, që Këshilli të fillojë një funksionim të mbarë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit, zoti Toska!

Ndonjë koment ose ndonjë sugjerim?

Fatmira Luli: Atëherë, edhe unë, si kolegët e mi parafolës, mendoj që struktura e re pasqyron gjerësisht dhe në mënyrë të mjaftueshme sektorët e rinj të punës, i cili ka ngarkuar ligji i ri dhe mendoj që do jetë një bazë e mirë për të filluar nga puna dhe për të përmbushur detyrimet, sfidat dhe detyrimet që na ka dhënë përpara ligji i ri dhe e gjithë paketa e ndryshimeve ligjore. Kështu që uroj që kjo të kalojë dhe të miratohet, të bëhet

funkionale sa më shpejt, në mënyrë që të na krijohet mundësia të gjithëve të fillojmë punën.

Naureda Llagami: Ndonjë sugjerim?

Ta kalojmë në votim?

Votim!

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Dakord. Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi të miratojë strukturën organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas strukturës bashkëlidhur këtij vendimi që keni të administruar në dosjen tuaj.

Dritan Hallunaj: Ju kërkoj ndjesë, por mendoja për vendimin: "...vendosi të miratojë strukturën organizative të administratës së Këshillit të Lartë Gjyqësor sipas strukturës bashkëlidhur...", pra mos duhet të gjejmë një shprehje tjetër që mos të vijmë... "...miratimin e strukturës..., sipas strukturës...". Vetëm një ndryshim të vogël që të kemi termin e duhur. Kaq!

Naureda Llagami: "...skemës bashkëlidhur", ose "...organigramës" dhe jemi më të saktë.

Dritan Hallunaj: Kam përshtypjen që organigrama ka tjetër koncept.

Më mirë 'skemë' sesa 'organigramë' apo 'strukturë'. Më mirë 'skemë'.

Naureda Llagami: Okej.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2019

PROCESVERVBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbajtur, më 18.01.2019)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Mbi miratimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 12:54 dhe mbaroi në orën 13:22.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|-----------------------------|--------------------------|
| 1. Naureda Llagami | (kryetare) |
| 2. Maksim Qoku | (zëvendëskryetar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Medi Bici | (anëtar) |
| 5. Brunilda Kadi | (anëtare) |
| 6. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 7. Ilir Toska | (anëtar) |
| 8. Alban Toro | (anëtar) |
| 9. Brikena Ukperaj | (anëtar) |
| 10. Erjon Muharremaj | (anëtar) |
| 11. Marçela Shehu | (anëtare) |

Merrnin pjesë gjithashtu:

- 1. Pjerin Prendi, Sekretar i Përgjithshëm pranë institucionit.*
- 2. Vildan Kaloshi, Drejtor në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor në Drejtorinë e Administratës dhe Financës pranë institucionit.*
- 4. Luljeta Laze, Drejtoreshë e ZABGJ-së.*
- 5. Krisulla Kasaj, Përgjegjëse në Sektorin e Organizimit të Mbledhjeve në Drejtorinë Juridike, Dokumentacionit dhe Organizimit pranë institucionit.*
- 6. Elis Kuçi, Zëdhënës pranë institucionit.*
- 7. Përfaqësues të EURALIUS-it.*
- 8. Përfaqësuese të USAID-it.*

RENDI I DITËS:

2. Mbi miratimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë tek çështja e dytë e rendit të ditës, lidhur me miratimin e përbërjes së Komisioneve të Përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Atëherë, sikurse e kemi diskutuar bashkë, për sa i përket ndarjes, shpërndarjes së anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor nëpër komisione, ajo që nga ana e Këshillit u mor parasysh në shpërndarjen e anëtarëve, së pari ishte eksperiencia e gjithsecilit dhe kontributin që ata mund të jepnin nëpër komisionet respektive. Së dyti, ishte mandatet respektive të gjithsecilit dhe, së treti, ishte referencat e gjithsecilit. Duke vlerësuar të gjithë këto kritere, Këshilli vendosi t'i propozojë, pra vendosëm të propozojmë këtë ndarje komisionesh, ku përfshihen në:

1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit – anëtare është zonja Naureda Llagami, zonja Fatmira Luli dhe zoti Medi Bici. Për këtë komision do jenë dy anëtarë zëvendësues, më konkretisht: Brikena Ukperaj dhe Erjon Muharremaj.

2. Komisioni Disiplinor – anëtarë do jetë zoti Medi Bici, zoti Dritan Halluni (*Hallunaj*) dhe zoti Maksim Qoku. Anëtarë zëvendësues për këtë komision do të jenë: zoti Alban Toro dhe zonja Brunilda Kadi.

3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale - do të jenë: zonja Brikena Ukperaj (Lubonja), zonja Brunilda Kadi, zoti Erjon Muharremaj. Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni do të jenë: zonja Fatmira Luli, zoti Medi Bici.

4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës – do të jetë zoti Ilir Toska, zonja Marçela Shehu dhe zoti Alban Toro. Anëtarë zëvendësues të këtij komisioni do të jenë: zonja Naureda Llagami dhe zoti Dritan Hallunaj.

Atëherë, jemi dakord me përmbajtjen, ta kalojmë në votim apo kemi diskutime prapë?

Ta kalojmë në votim?

Atëherë, po!

Maksim Qoku: Dakord.

Brunilda Kadi: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ilir Toska: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Erjon Muharremaj: Pro.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Medi Bici: Pro.

Naureda Llagami: Pro.

Atëherë, Këshilli vendosi shpërndarjen e anëtarëve në Komisionet e Përhershme si më poshtë: 1. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit – zonja

Naureda Llagami, zonja Fatmira Luli dhe zoti Medi Bici. Anëtarë zëvendësues do të jenë zonja Brikena Ukperaj, zoti Erjon Muharremaj.

2. Në Komisionin e Disiplinës – anëtarë do jetë zoti Medi Bici, zoti Dritan Halluni (*Hallunaj*) dhe zoti Maksim Qoku. Zëvendësues do të jenë: zoti Alban Toro, zonja Brunilda Kadi.

3. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale - do ketë këtë përbërje: zonja Brikena Ukperaj (Lubonja), zonja Brunilda Kadi, zoti Erjon Muharremaj. Me anëtarë zëvendësues: zonjën Fatmira Luli, zotin Medi Bici.

4. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës – do të jetë zoti Ilir Toska, zonja Marçela Shehu dhe zoti Alban Toro. Anëtarë zëvendësues do të jenë: zonja Naureda Llagami dhe zoti Dritan Hallunaj.

Atëherë, komisionet konsiderohen të miratuar.

Brunilda Kadi: Atëherë, siç e kemi diskutuar jashtë mbledhjes plenare në diskutimet tona, shqetësim shumë të madh kemi zbatimin e skemës së delegimit sepse siç të gjithë jemi në dijeni, situata është shumë emergjente. Kanë kaluar pothuajse gati 2 muaj kohë – në qoftë se ma konfirmon administrata – që nuk janë bërë veprimet që kryente dikur Këshilli i Lartë i Drejtësisë për komandimin e gjyqtarëve për çështje të caktuara dhe nga informacioni që kemi të gjithë, është një numër shumë i madh voluminoz çështjesh që presin për t'u caktuar, dikur, sipas ligjit të vjetër me skemën e komandimit, tani, ligji, siç e dimë të gjithë, ka një situatë komplet të re që të gjithë e dimë që është e vështirë për t'u zbatuar. Kështu që, sugjeroj që neve, në ditët më të para të javës tjetër, duhet patjetër të mblidhemi në mbledhje plenare dhe të marrim një vendim të studiuar, duke marrë edhe opinionet e dy misioneve që asistojnë gjithë kohës Këshillin dhe që kanë asistuar edhe në draftimin e ligjeve dhe duhet në mënyrë urgjente të marrim një vendim në lidhje me këtë sepse siç të gjithë e dimë që çështjet gjyqësore që presin për t'u plotësuar me trupa gjykues kanë pasoja të pariparueshme, që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut në radhë të parë. Kështu që, të gjithë e dimë që është e vështirë pjesa e legjislacionit... Që mos t'i përsërisim, se të gjithë i kemi diskutuar jashtë mbledhjes. Duhet patjetër të gjejmë një zgjidhje, perfektë nuk e zgjidhim dot, por të gjejmë zgjidhjen me pasojat më të vogla jo pozitive. Kështu që, ju sugjeroj të gjithëve që mbledhja më e

parë javës tjetër, ne duhet të mblidhemi urgjentisht për këtë pjesë dhe të marrim masat paraprake për këtë situatë.

Naureda Llagami: Bruna, të falënderoj për shqetësimin. Në fakt, unë, në cilësinë e Kryetares, kam marrë masa lidhur me situatën që ju relatuat. Gjatë një takimi që kemi pasur me të dy projektet që asistojnë Këshillin, i është kërkuar një mendim i specializuar mbi aplikimin e skemës së parashikuar në ligjin “Për statusin...” dhe kush do ishte ky aplikim, për ta adresuar situatën emergjente që ndodhet sot sistemi gjyqësor dhe pamundësinë për të reaguar ndoshta edhe në bazë të dispozitave që rregullon ligji, unë doja t’ju informoja që jo më larg, por sot në orën 10:30 unë kam marrë një imeil (*e-mail*) me një propozim konkret nga projekti i “Xhastis for all” (“*Justice for all*” - *Drejtësi për të gjithë*).

Dhe unë kam dy çështje të cilat do t’i adresojë me urgjencë, brenda javës tjetër, që është përfshirjen e një rregulloreje për delegimin. Nuk dua ta them termin ‘rregullore’, por ndoshta rregulla mbi funksionimin e skemës së delegimit, dhe një çështje tjetër që e kam imediate, që po na skadojnë edhe afatet ligjore, është edhe përcaktimi i numrit të magjistratëve që duhet t’i propozojmë Shkollës së Magjistraturës. Aktualisht, doja t’ju informoja që unë i kam dërguar një shkresë Shkollës së Magjistraturës lidhur me nevojat që ka kjo shkollë dhe kapacitetin që mund të jetë për magjistratët e rinj. Jam në pritje të kthimit të përgjigjes dhe unë besoj që javës tjetër, dy çështjet imediate (jo vetëm këto të dyja, por mund të shtojmë edhe çështje), do jenë këto: pra, miratimi i rregullave për funksionimin e skemës së delegimit dhe miratimin e vendeve vakante për kandidatët magjistratë që do i propozohen Shkollës së Magjistraturës.

Ndonjë sugjerim tjetër?

Brunilda Kadi: Edhe një gjë tjetër që unë mendoj që ne duhet ta kemi në prioritet për ta diskutuar se çfarë duhet të bëjmë sepse askush nga ne nuk është i qartë se çfarë mund të bëjmë edhe nga ana procedurale, në lidhje me ankimet që bëjnë qytetarët. Ne të gjithë e kemi shumë të qartë situatën, që ne nuk jemi kompetentë, ndërkohë e dimë të gjithë që organi kompetent që merret me hetimin nuk është krijuar akoma dhe ne nuk kemi as edhe një ide se kur do krijohet, ndërkohë që qytetarët nuk kanë njohuri të posaçme në këtë fushë dhe reagimi, ai impakti që krijohet në publik është tërësisht i

ndryshëm nga ajo që do perceptohet nga një profesionist, por ne mendoj se duhet të diskutojmë nëse duhet të mbajmë një qëndrim. Unë nuk e kam të qartë se çfarë duhet të bëjmë. Thjesht duhet ta diskutojmë se çfarë duhet të bëjmë. Ndoshta një njoftim për shtyp që të bëjmë me dije qytetarët sepse po vijnë po depozitojnë ankime dhe kam përshtypjen që neve s'kemi kompetencë as fizikisht nuk mund t'i pranojmë t'i depozitojmë, sepse edhe ata konfondohen duke e ditur që po e sjellin në vendin e duhur dhe ndërkohë iu ikin edhe afatet e ankimit, e shumë pasoja të tjera.

Kështu që, ne duhet të kemi një reagim, qoftë edhe zyrtar dhe njëkohësisht mund të bëjmë edhe pjesën e detyrës sonë, t'i drejtohem qoftë edhe Kuvendit të Shqipërisë ose edhe organeve të tjera që e kanë për detyrë, që të ecin me pjesën e Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë sepse është një gjë shumë e rëndësishme dhe imediate, që çdo sekondë të ditës duhet t'i kthesh përgjigje një situatë të tillë, dhe neve jemi në kushtet që s'kemi asnjë gjë në dorë, thjesht ta diskutojmë bashkë se çfarë do bëjmë, qoftë edhe një njoftim dhe ta diskutojmë. Por mendoj që duhet të jetë emergjente javës tjetër, në qoftë se do të kemi mbledhje, për të diskutuar dhe për të reaguar në një formë. Thjesht e hodha si diskutim.

Medi Bici: Kisha unë diçka, zonja Kryetare.

Meqenëse unë jam edhe anëtar zëvendësues i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, bëj me dije Këshillin, që ju e keni marrë vesh nga mjetet e informacionit, që është bërë mbledhja e parë dhe përveç anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, pra rankimit, është detyrë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi edhe rankimi i kandidaturave për Kryeinspektorin, Inspektorin e Lartë të...

Ka një problem për sa i përket Inspektorit sepse sipas ligjit, duhen 5 kandidatura dhe realisht kanë kandiduar vetëm 3 persona, njëri nga të cilët e ka kaluar shkallën e parë të vetingut, por i është ankimuar çështja në Komisionin e Apelimit. Kandidati tjetër nuk ka bërë ventingun, nuk ka kaluar as në shkallën e parë, kurse kandidatja tjetër vjen nga jashtë gjyqësorit dhe për atë duhet bërë një vlerësim Këshilli i Emërimeve në Drejtësi. Pra kjo është vështirësia dhe kam mendimin që do zgjasë dhe bashkohem me mendimet që ka Bruna, që ne duhet të bëjmë një reagim.

Naureda Llagami: E do fjalën njeri tjetër?

Brunilda Kadi: Ndjesë! Thjesht doja të shtoja që në këtë reagim ne duhet të marrim zyrtarisht një opinion nga dy misionet në lidhje me këtë situatë. Se si e vlerësojnë ata, mund të jetë një zgjidhje me sa më pak pasoja të paligjshme.

Naureda Llagami: Atëherë, për të sqaruar, un kam pasur një takim me të dy drejtuesit e misionit, projekteve të asistencës të Këshillit dhe në këtë lloj takimi, kuptohet, unë i parashtrova edhe një herë kërkesën që ne i kishim bërë në mbledhjen e mëparshme, të dhjetorit, ku ne i kërkuam me shkrim, të paktën me procesverbalin e mbledhjes, i kërkuam një mendim të specializuar të dy projekteve. Mu komunikua në takim që opinionin, në mënyrë të shkruar, do na vihet në dispozicion në fund të javës, që do të thotë, jemi e premtë sot, unë shpresoj që të hënën ne të kemi një opinion dhe një qëndrim me shkrim të të dy projekteve. Në rastin e parë që ne do kemi një qëndrim me shkrim, unë kam gatishmërinë time personale por besoj edhe të gjithë anëtarëve, që ne atë çështje ta kalojmë për diskutim në mbledhjen e radhës. Kështu që, në momentin që unë do kem opinionin dhe do e ndaj midis jush opinionin, pa diskutim që do jetë pjesë e mbledhjes së radhës.

Nga ana tjetër, doja t'ju informoja që lidhur me qëndrimin e Këshillit për situatën emergjente që i krijohet për shkak të mungesës së ngritjes së institucioneve, neve ramë dakord që me situatën që kishim me gjyqtarin Roland Hysi, që t'i çonim një shkresë të paktën, institucioneve kompetente si Kuvendi dhe Komisioni për monitorimin e ngritjes së institucioneve të drejtësisë, lidhur me shqetësimin që ne kemi, për përsëritjen e situatave të tilla dh që çfarë duhet të bëjë Këshilli, në kuptimin që ndodhemi para një situatë të tillë.

Kuptohet që, kemi koordinuar që një qëndrim të tillë ta bëjmë së bashku edhe me Këshillin e Lartë Prokurorial, të Prokurorisë, kështu që unë besoj që shkresa së shpejti do dali në formën e një qëndrimi ndërgjegjësimit ndaj institucioneve përgjegjëse.

Kurse, lidhur me qëndrimin tonë, unë jam në pritje të këtij opinionin, i cili deri tani (ka kaluar tre javë), akoma nuk na është vënë në dispozicion. Kështu që, meqë e kërkuam këtë gjë edhe në mbledhjen e mëparshme, me ardhjen e opinionit, pa diskutim që unë do e ndaj me ju dhe do e diskutojmë bashkë.

Po, zoti Toska!

Ilir Toska: Atëherë, duke vijuar diskutimin e parë të Brunës, sa i përket sensibilitetit të çështjeve të skemës së delegimit, jo thjesht për skemën, por për çështjet që janë në pritje dhe në skadencë të afateve ligjore, ne i kërkuam një takim të dy misioneve dhe sot ju na shpërndatë një opinion të tyre me shkrim, ku reflektohen disa alternativa për zgjidhjen e situatës. Në fakt, alternativat ligjore jepen në opinion dhe ato duan kohën e vetë dhe unë personalisht e kam të paqartë se si nesër ne mund të zgjedhim një situatë shumë më tepër emergjente se sa ne do mundemi t'i aplikojmë të gjitha alternativat që na sugjerojnë. Mbase unë e kam të nevojshme edhe të komunikoj drejtpërdrejt me ekspertët e të dy misioneve që t'i themi situatën konkrete, për të kuptuar edhe ata ç'duhet të bëjmë ne apo ç'përgjegjësi kemi ne, qoftë që ditën e sotme, aq më pak ditë më përpara se të sotmes dhe shumë më tepër pas kësaj të sotmes. Nuk e di nëse do të ishin të gatshëm, që ditën e sotme ulem dhe diskutojmë me ata për të gjetur një zgjidhje sa më të mirë ligjore dhe për të zgjidhur vërtet një ngërç shumë të madh që kemi.

Naureda Llagami: Atëherë, ne këtu i kemi prezent ekspertët e...

A sugjeroni që të kemi një takim një grup pune nga ana jonë bashkë me ekspertët dhe të flasim lidhur me këtë çështje, pra, mbi opinionin e dhënë të ekspertëve? Sot ose ditën e hënë në një orar të përcaktuar nga ju?

Mendoni?

Eksperte USAID: Parimisht dakord, por nëse na jepni pak kohë që të diskutojmë edhe...

Naureda Llagami: Me EURALIUS-in.

Eksperte USAID: Me EURALIUS-in patjetër, por edhe me drejtuesit.

Naureda Llagami: Atëherë...

(Anëtarët flasin pa ndezur mikrofonat.)

Unë vlerësoj, në bazë të propozimit të zotit Toska, të mundësohet një takim sa më shpejt me përfaqësuesit e projekteve dhe ata që kanë kontribuar në dhënien e opinionit, për të sqaruar situatën e skemës së aplikimit të skemës së delegimit, vështirësitë që ka kjo skemë në situatën aktuale të sistemit tonë gjyqësor.

Pra unë do sugjeroja që në këtë takim të ishin të gjithë anëtarët gjyqtarë, me qëllim që të adresojnë sa më mirë problematikën e secilës gjykatë që ato e njohin shumë

mirë, për të gjetur zgjidhjet më optimale dhe në përputhje me ligjin. Nëse nuk kemi ndonjë gjë tjetër, ta konsiderojmë mbledhjen të mbyllur për sot?

Ju falenderoj për prezencën!

Ju uroj uikend (*weekend*) të mbarë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

Kryetare

Naureda Llagami

Redaktore-Stenografe

Rosalba Xhabrahimi